



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2023:249977

Datë: 18.06.2024

Numri i dokumentit: 05827727

C.nr.2272/23

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil, gjyqtarja Erlinda Elezi-Tosku, me bashkëpunëtoren profesionale Bionda Rexhepi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Sh.A. nga Gjilani, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson A.S., avokat nga Gjilani, kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Kosovës, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore, me objekt kontesti kompensimi i shpërblimit për pagat mujore ekuivalente me pagën e fundvitit për shkak të vlerësimit të kënaqshëm dhe mungesës së masave disiplinore, me vlerë të kontestit 3,996.55 euro, jashtë seance gjyqësore, më datë 05.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APPROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësit Sh.A. nga Gjilani dhe DETYROHET e paditura Qeveria e Republikës së Kosovës, Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Kosovës, me seli në Prishtinë, që në emër të shpërblimit për pagat mujore ekuivalente me pagën e fundvitit për shkak të vlerësimit të kënaqshëm dhe mungesës së masave disiplinore për vitin 2020 dhe 2021, t'ia paguaj shumën prej 1,598.62 euro, me kamatë ligjore prej 8 % nga data 16.11.2023, si datë e paraqitjes së padisë, e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

II. REFUZOHET e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit e kërkuar për shpërblimin e pagës mujore sa i përket vitit 2018, 2019 dhe 2022 në shumën prej 2,397.93 euro.

III. DETYROHET e paditura, që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumën e përgjithshme prej 135.00 euro, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, më datë 16.11.2023, ka paraqitur padi në këtë gjykatë, kundër të paditurës, për kompensim e shpërblimit për pagat mujore ekuivalente me pagën e fundvitit për shkak të vlerësimit të kënaqshëm dhe mungesës së masave disiplinore, me vlerë të kontestit 3,996.55 euro.

Në padi ka theksuar se paditësi është në marrëdhënie pune te e paditura në pozitën e punës Toger i Operativës, ndërsa bazuar në nenin 29 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës të datës 14.11.2018 dhe 29.09.2021 të njëjtit i takon shpërblimi për pagat mujore ekuivalente me pagën e fundvitit për shkak të vlerësimit të kënaqshëm dhe mungesës së masave disiplinore sa i përket viteve 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022. Për realizimin e këtyre të drejtave, ka theksuar se i është drejtuar të paditurës me kërkesë, mirëpo nuk ka pranuar përgjigje. Gjykatës i ka propozuar që të aprovojë të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe të detyrojë të paditurën në kompensimin e shpërblimeve të pagave të fundvitit duke llogaritur nga 799.31 euro për secilin vit, si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në mënyrë të specifikuar: 104.00 euro, për përpilim të padisë dhe 31.00 euro, për taksë gjyqësore.

E paditura në përgjigje në padi ka deklaruar se e kundërshton në tërësi të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke theksuar se kërkesa e paditësit është e parashkruar dhe si e tillë e pathemeltë. Paga e 13-të, ka shtuar se nuk është realizuar për asnjë punonjës të Policisë së Kosovës, ndërsa nuk ka kontestuar faktin se paditësi është në marrëdhënie pune te e paditura duke u mbështetur në vërtetimin e punësimit të lëshuar te e paditura. Kompensimi i pagës së 13-të nuk është paraparë në mënyrë imperative dhe kërkesa për ndarje buxhetore nuk është aprovuar nga Ministria e Financave, ndërsa kjo pagë do të mund të kompensohej vetëm brenda mundësive institucionale, ligjore dhe financiare, e të cilat mundësi nuk janë krijuar. Ka konsideruar se kërkesa e paditësit për vitin 2018 dhe 2019 është e parashkruar në bazë pasi është parashtruar pas më tepër se 3 vite. Gjykatës i ka propozuar të refuzojë të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seance gjyqësore, bazuar në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), në të cilën është përcaktuar se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë” dhe 399.1 që përcakton se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do te jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”.

Gjykata ka gjetur se mes palëve nuk është kontestues fakti se paditësi është i punësuar me orar të plotë në Policinë e Kosovës që nga data 24.07.2000 (vërtetimi nr.ref.05/3-06/SRR/0958/2023 i dt. 18.10.2023), për vitin 2020 dhe 2021 është vlerësuar me vlerësim plotësisht të kënaqshëm (formulari i vlerësimit të performancave për këto vite) dhe është paguar në shumën prej 799.31 euro në muaj (vërtetimi si më lartë).

Gjykata bazuar në nenin 329.1 të LPK-së, provat në shkresat e lëndës i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritore, pasi të njëjtat janë lëshuar nga organi shtetëror – këtu vet e

paditura, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Nga kjo gjendje faktike e vërtetuar, gjykata gjeti se themelësia e kërkesëpadisë, e aprovuar si në pikën I dhe jo themelësia e kërkesëpadisë e refuzuar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi del bazuar në dispozitat e nenit 55, paragrafi 1 të Ligjit të Punës që përcakton se “I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”; nenin 44, paragrafi 2 të Ligjit për Policinë që përcakton se “Marrëdhënia e punës për personelin policor rregullohet me akt nënligjor”; nenin 55, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7 se “Drejtori i Përgjithshëm nxjerr aktet nënligjore për marrëdhënien e punës, siç përshkruhet në paragrafin 2. të nenit 44 të këtij ligji”, e lidhur me Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2018 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës (dt.14.11.2018), që në nenin 5, paragrafi 2 përcakton se “Në polici janë të punësuar tri kategori të personelit policor”; pika 2 e këtij se “Stafi civil, i cili punësohet në Polici për të kryer shërbime mbështetëse dhe administrative”; si dhe nenin 29, paragrafi 2 se “Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit”.

Zbatimi i këtyre dispozitave është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr.213/2023 të dt.09.10.2023.

Në rastin konkret gjykata gjeti se e paditura ka pasur për detyrim që paditësit si i punësuar pranë saj që të ia paguaj pagën e 13-të për çdo fundvit, pasi që janë plotësuar edhe kushtet nga ana e paditësit siç parashihen në nenin 29 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ Nr.02/2018, i datës 14.11.2018, më saktësisht, vlerësimi i performancës për vitin 2020 dhe 2021, e po ashtu ndaj të njëjtit nuk është shqiptuar asnjë masë disiplinore. Nga kjo arsye, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, kurse lartësinë e vërtetoi nga vërtetimi i punësimit të lëshuar nga vet e paditura.

Gjykata për kamatën ka vendosur duke u bazuar në dispozitën e nenit 382 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Meqë e paditura është thirrë në parashkrim, gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës që përcakton se “Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret gjen zbatim neni 87 i LP-së, pasi kërkesa e paditësit është kërkesë monetare, e cila është paraqitur më datë 16.11.2023, ndërsa parashkruhet prej 3 vite nga data e paraqitjes së kërkesës (16.11.2020), kurse kërkesa e paditësit është edhe për periudhën kohore 2018 e 2019, pra për periudhë pjesërisht të përfshirë në parashkrim, prandaj pjesën e përfshirë në parashkrim (vitin 2018 dhe 2019), gjykata e refuzoi të pabazuar.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, edhe sa i përket kërkesës për kompensimin e pagës së fundvitit për vitin 2022 pasi ka gjetur se me UA nr.01/2021 e cila ka hyrë në fuqi më dt.29.09.2021 kompensimi i pagës mujore realizohet vetëm nëse ka mjete buxhetore për këtë kompensim. Bazuar në faktin se avokatura shtetërore si organ qendror i administratës në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë me anë të përgjigjes në padi ka njoftuar se kërkesa për ndarje të buxhetit lidhur me këtë kompensim nuk është aprovuar nga Ministria e Financave, gjykata vlerëson se e paditura ka provuar se nuk ka mundësi buxhetore për të shpërblyer pagën e tillë, prandaj refuzoi kërkesën për shpërblimin e pagës mujore sa i përket vitit 2022. Ndërsa, në rastin konkret me UA nr.02/2018 kompensohet shërblimi i një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit sa i përket vitit 2018, 2019, 2020 dhe 2021, ashtu që e njëjta nuk gjen zbatim sa i përket vitit 2022.

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore nga neni 449, 452, 453 dhe 463 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e paditësit në këtë procedurë dhe kërkesën e specifikuar për këto shpenzime, ndërsa sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 dhe 7 të Rregullorës për Tarifën e Avokatëve të Kosovës.

Nga të lartëcekurat, bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.2272/2023, më datë 05.03.2024

Gjyqtarja,
Erlinda Elezi-Tosku

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit në Gjykatën e Apelit, përmes këtij Gjykate.